



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

RREGULLORE

PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2017

Në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi Vetqeverisje Lokale të Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-204 dhe Ligjit Nr. 03/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 03/L-204 mbi "Tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë", Udhëzimet Administrative nr. 03,04,05,06,07,08,09,10/2011, dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi Komunal i Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 27 Shtator 2016, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

MBI CAKTIMIN E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN 2017

Neni 1

- 1.1 Në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-100, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji Nr. 03/L-204 caktohen normat tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2017 për Komunën e Rahovecit që do të jetë si vijon:

Përshkrimi	Norma 2017
Pronat rezidenciale	0,15 %
Pronat komerciale	0,17 %
Pronat industriale	0,16 %
Pronat bujqësore	0,15 %
Pronat e braktisura	0,15 %
Strukturat e pabanuara	0.15 %

- 1.2.1 Kategoritë e lartpërmendura duhet të caktohen në bazë të definimëve në nenin 7.1 të Ligjit Nr. 03/L-204.

Neni 2

2.1. Baza tatimore për tatimin në pronë duhet të jetë vlera e tregut e pronës e përcaktuar në pajtim me standardet e vendosura nga MF ashtu siç kërkohet në nenin 13 mbi "Vlerësimin e pronave" të Ligjit Nr. 03/L-204 ,Udhëzimit Administrativ 04/2011

2.2. Zyra e Tatimit në Pronë i raporton Asamblesë Komunale me shpjegime detale metodat e vlerësimit të aplikuara për caktimin e vlerës së tregut të pronave të paluajtshme.

2.3. Neni i mëposhtëm aplikohet dhe mund të votohet vetëm nëse zyra e tatimit në pronë ka informata të gatshme dhe të qëndrueshme mbi kualitetin e objekteve që duhet tatimuar.

Në bazën tatimore do të llogaritet edhe amortizimi material - koeficienti mbi gjendjen e pronës (Udhëzimi Administrativ 03/2011). Gjendja e pronës do të thotë se me çfarë cilësie të materialit ndërtimorë është i ndërtuar objekti. Kjo do të jetë e ndarë në 5 kategori, dhe koeficientet e gjendjes së ndërtesës janë me sa vijon

Cilësia e pronës – Kategoritë	Koeficienti 2017
1. Objektet me material të shkëlqyeshëm-shumë të mirë	1.1
2. Objektet me material të mirë	1.0
3. Objektet me material mesatarë	0.8
4. Objektet me material: të dobët	0.6
5. Objektet me material shumë të dobët	0.5

2.4. Në raste të veçanta mund të llogariten edhe amortizime të tjera të parapara me Ligjin Nr. 03/L-204

2.5. Metoda e llogaritjes së amortizimit të objektit mund të ndryshoj nëse Ministria për Financa lëshon udhëzim të veçantë administrativ.

2.6. Baza tatimore për Komunën e Rahovecit do të jetë

SHFRYTËZIMI I PRONËS	Z O N A	ÇMIMI NË € PËR M/2 2017	KOEFICIENTI 2017
Rezidenciale-Banesat	I	220,00	0.15 %
	II	220,00	0.15 %
Rezidenciale-shtëpitë	I	220,00	0.15 %
“	II	180,00	0.15 %
“	III	150,00	0.15 %
“	IV	130,00	0.15 %
Komercale-	I	410,00	0.17 %
	II	370,00	0.17 %
	III	340,00	0.17 %
	IV	250,00	0.17 %
Industriale	I	270,00	0.16 %
	II	270,00	0.16 %
	III	250,00	0.16 %
	IV	180,00	0.16 %
Pronat e braktisura	Për të gjitha zonat	50,00	0.15 %
Bujqësore	I	70,00	0.15 %
	II	70,00	0.15 %
	III	70,00	0.15 %
	IV	70,00	0.15 %
Pronat tjera – garazhat jo komerciale	Për të gjitha zonat	70,00	0.15 %
Qendrat sportive	Për të gjitha zonat	90,00	0.17 %
Pishinat	Për të gjitha zonat	90,00	0.17%

Neni 3.

3.1. Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Rahovecit janë përcaktuar katër zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë:

- Zona e I-rë

Në bazë të karakteristikave dhe kriterëve mbi vlerësimin e bazës tatimore në këtë zone përfshihen:

- a) Nga jugu i qytetit të Rahovecit-pompa e derivative "Haxhijaha", vazhdon nëpër rrugën e UÇK-së Xhelal Hajda-Toni, Xhevat e Alajdin Elshani deri te mulliri elektrik për përpunimin e drithërave.
- b) Po ashtu në të njëjtën zonë përfshihen edhe territori.
Nga udhëkryqi (semaforët), sh.f. "Isa Boletini" nëpër rrugën Avdullah Bugari, përfundon në fund të rrugës Mezahir Isma (shtëpia e Muharem Ismes) nga vija rrugore gjer në 40 m.
- c) Në të njëjtën zone do të përfshihej:
Nga udhëkryqi në hyrje të Rahovecit vazhdon në rrugën tranzite UÇK-së gjerë te Maja e Shkodranit nga vija rrugore gjer në 40m nga të dy anët.
- d) Fillon prej Urës së Fshenjtë nëpër magjistrale Gjakovë – Prizren gjerë te kufiri administrativ Krushës së Madhe nga vija rrugore gjer në 40m nga të dy anët.
- e) Nga udhëkryqi i Xërxës nëpër rrugën magjistrale Xërxë-Rahovec gjerë te pompa e derivateve "Haxhijaha" nga vija rrugore gjer në 40m nga të dy anët.

Zona e II-të

Edhe kjo zone është e përfshirë në bazë të karakteristikave të cekura më lartë.

- a) Në këtë zonë përfshihet pjesa e e mbetur e qytetit të Rahovecit nga zona e pare Xërxa, Fortesa, Celina deri te objekti i shkollës fillore Faik Konica.
- b) Rruga regjionale Gradish – Kramovik me këto vendbanime: Gexhe, Malësi e Vogël, Ratkoc, Denj, Dabidol, Çifllak dhe Kramoviku.
- c) Rruga prej Mullirit elektrik Rahovec- Brestoc- Krusha e Madhe, në këtë zone përfshihen këto vendbanime: Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc.
- d) Nga varrezat e qytetit në rrugën regjionale Rahovec-Apterush-Therand, gjer në kufirin administrative të komunës së Rahovecit respektivisht përfshihen këto vendbanime: Hoçë e Madhe, Apterush nga vija rrugore gjer në 40m nga të dyja anët.

Zona e III-të:

Edhe kjo zone i ka karakteristikat e veta në bazë të cilave është bërë përfshirja e këtyre vendbanimeve

- a) Sopniq, Patoqan i Ulët, Patoqan Epërm, Nashpall, Drenoc, Senovc, Pastasel, Vranjak, Bratatin, Reti dhe Reti e Ulët dhe Palluzhë

-Zona e IV-të:

Në këtë zone përfshihen të gjitha vendbanimet e Komunës së Rahovecit të cilat nuk janë përfshirë në zonat e cekura më lartë, respektivisht vendbanimet malore siq janë: Zatriq , Kaznik ,Guri i Kuq dhe Mrasor

Neni 4

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronë e të cilat janë të cekura në nenin 8 pika 1.1-1.7,2,3,31-3.2 të Ligjit Nr. 03/L-204 , lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Rahovecit

Neni 5

Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veqanta mund të bëhet konform nenit 16 pika 1-5 të Ligjit Nr. 03/L-204 Udhëzimit Administrativ 06/2011

Neni 6

Në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-204 mbi tatimin ne pronën e paluajtshme, përgjegjësitë komunale dhe Udhëzimit Administrativ 05/2011 nenin 1-5. Kryetari i Komunës së Rahovecit e emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave Administrative të tatimpaguesve për vitin 2017

Neni 7

Ligjit Nr. 03/L-204 i datës 07 shtator 2010 mbi tatimin ne pronën e paluajtshme ,si dhe Ligji Nr. 03/L-10 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-204 “Tatimin e Pronës të Paluajtshme në Kosovë “ dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e aprovimit të saj nga ana e Kuvendit Komunal dhe konfirmimi mbi ligjshmërinë e saj nga ana e MAPL-së, ndërsa do të zbatohet prej 1(një) Janari 2017 dhe do të publikohet në web faqen zyrtare të komunës.

01 Nr. 3008
Rahovec, 27.09.2016

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odaljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 3008
Br. prot. 27.09.2016
Më 27.09.2016
RAHOVEC - ORAHOVAC

 Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani